



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

Prishtinë, 3 mars 2009

Zt. Jakup Krasniqi
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kopje: zt. Gani Koci
Kryetar i Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa

**Ekzekutimi i pagave për personelin e ZRRUM për vitin 2009 sipas Buxhetit të
aprovuar nga Kuvendi i Kosovës**

I nderuari zt. Kryetar i Kuvendit,

Buxheti i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) për vitin 2009 në kategorinë e pagave **nuk po zbatohet ashtu siq është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës** edhe pas më se 2 muajve prej fillimit të vitit 2009.

Në fakt, përkundër përpjekjeve të ZRRUM në komunikimin intensiv me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe me Ministrinë e Shërbimeve Publike (MSHP), si dhe përkundër **rekomandimit të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa drejtuar MSHP dhe MEF** (i datës 19 janar 2009), vendimi i Kuvendit të Kosovës për lartësinë e buxhetit të ZRRUM për vitin 2009, i sanksionuar edhe me Ligjin për Buxhetin e Kosovës 2009, nuk po zbatohet për shkaqe të cilat janë të panjohura për ne dhe të cilat mund vetëm ti paramendojmë (paqartësia e kompetencave, neglizhenca, etj.).

Në korrespondencën tonë që kemi pasur gjatë këtyre muajve me MSHP dhe MEF (5 letra të dërguara lidhur me këtë çështje) si dhe takimeve të shumëta që kemi pasur me zyrtarët e këtyre 2 ministrive, nuk kemi arritur të realizojmë të drejtën tonë për buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Konsideroj se kjo është **cënim serioz i pavarësisë financiare dhe operative të ZRRUM** si rregullator i pavarur, pavarësi kjo që është **garantuar me Kushtetutën e Kosovës** (neni 142) dhe poashtu me **ligjet tjera në fuqi** si: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (neni 65 dhe 66) dhe me Ligjin për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 (Ligji Nr.03/L-086).

Dëshiroj të theksoj me këtë rast se aprovimi i buxhetit të ZRRUM është zhvilluar në pajtim me procedurat ligjore të parapara, sikurse edhe për agjencitë dhe rregullatorët tjerë, me ç`rast janë zhvilluar dëgjimet buxhetore para Komisionit

Parlamentar për Buxhet dhe Financa ku janë adresuar hollësisht të gjitha aspektet e buxhetit të ZRRUM përfshirë edhe pagat e stafit. Si rezultat i këtij procesi është aprovuar buxheti i ZRRUM për vitin 2009 i cili do të duhej të zbatohet në tërësi në masën dhe lartësinë e aprovuar. Mosrespektimi i këtij buxheti nga ministritë përkatëse (ashtu siç po ndodhë aktualisht) konsideroj se është **shkelje e dispozitave të Kushtetutës, ligjshmërisë dhe vendimeve të Kuvendit të Kosovës.**

Prandaj, ju lutem që në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësive tuaja si kryetar i institucionit më të lartë të vendit të cilit i jep përgjegjësi ZRRUM, të angazhoheni në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në mënyrë që **buxheti i ZRRUM për vitin 2009 në kategorinë e pagave të zbatohet** ashtu siq është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Me respekt,

Afrim Lajçi
Drejtor i ZRRUM